



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS LEPOSAVIQ

---

Numri i lëndës: 2021:012617

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05742112

**P.nr.31/2017**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Dega në Leposaviq** - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Qëndresa Tahiri - Islami, me bashkëpunëtoren profesionale Edita Koliqi, në çështjen penale ndaj të akuzuarit M.V, për shkak të veprës penale: Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1, nën-par. 1.1 të Kodit (Nr.04/L-082) Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*), sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1653/2015, të datës 06.01.2016, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me datë 02.05.2024, në mungesë të Prokurorit të Shtetit Arjan Xhema, të akuzuarit M.V, si dhe mbrojtësit të të akuzuarit av.Bedri Miftari, me datë 03.05.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 28.05.2024, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

Ndaj të akuzuarit:

M.V, nga i ati ....., e ëma ....., i lindur me datë ....., në Mitrovicë, me adresë të vendbanimit në rrugën “.....” nr... - Leposaviqit, ka të kryer shkollën e mesme, student, i gjendjes së mesme ekonomike, serb, shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

**Sepse:**

Me datë 12.12.2015, rreth orës 22:30, i pandehuri në Leshak, në rrugën “Brace Nativuca” nr.15, me qëllim që me marrjen e sendeve të huaja të luajtshme vetit ti sjelli përfitim pasuror të kundërligjshëm nga kasa e lokalit MK “Trgovina” ka marr 3.000 dinar si dhe 60 euro para

metalike, në atë mënyrë që me përdorimin e forcës ka thyer derën hyrëse të lokalit ka hyrë brenda në lokal dhe nga kasa ka marr paratë e lartcekura.

-Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1, nën-par. 1.1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të neneve: 1, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 41, 43, 46, 49, 50, 51, 52, 73,74, 75, 76, 83 e lidhur me nenin 327 të KPRK-së, dhe neneve: 358, 364, 449, 462 të KPP-së, të akuzuarit, i:

## **S H Q I P T O N**

-DËNIM ME GJOBË në shumë prej 600 (gjashtëqind) euro, të cilin dënim-gjobë obligohet ta paguaj brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 46 par.3 të KPRK-së, ashtu që të pandehurit, dënimin me gjobë do të i'a zëvendësoj në dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguar, me një (1) ditë burgim.

- DËNIM ME BURGIM të kushtëzuar në kohëzgjatje prej një (1) vit dhe tre (3) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit, në kohëzgjatje prej dy (2) viteve, nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.

- Të pandehurit M.V, koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak nga data 14.12.2015 e deri me datë 11.01.2016 i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim të kushtëzuar.

-OBLIGOHET i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej tridhjetë (20) euro, po ashtu edhe në emër të fondit të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

-Pala e dëmtuar M.M, për kërkesën pasurore juridike, udhëzohen në kontest të rregullt juridiko - civil.

## A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.1653/2015, të datës 06.01.2016, kundër të akuzuarit M.V, për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1, nën-par. 1.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 02.05.2024, në të cilën ka prezantuar Prokurori i Shtetit Arjan Xhema, i akuzuari M.V, mbrojtësi e tij sipas detyrës zyrtare, av.Bedri Miftari dhe përkthyesi gjyqësor Hysen Mikullovc.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, Gjyqtarja e vetme gjykuese e ka njoftuar të pandehurin lidhur me të drejtat e tij në këtë çështje penale dhe pasi që është bindur se i pandehuri i ka kuptuar udhëzimet e gjykatës, të njëjtit i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë, ashtu që në këtë seancë i pandehuri lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se ndjehet fajtor dhe se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës. Ka shprehur pendim për rastin e ndodhur dhe premtim se më nuk do të përsëriten veprime të tilla, duke theksuar se menjëherë pasi ka kryer veprën, vetë është lajmëruar në polici dhe që nga hera e parë që ka ndodhur kjo vepër asnjëherë më nuk ka ra ndesh me ligjin, si dhe me të dëmtuarin janë fqinjë, janë pajtuar dhe kanë raporte shumë të mira, këtë vepër penale e ka kryer kur ka qenë i dehur dhe menjëherë paratë ia ka kthyer të dëmtuarit.

Prokurori i shtetit, pas pranimin të fajësisë nga ana e të pandehurit, ka kërkuar nga gjykata që të njëjtin ta shpall fajtor për veprën penale, të i shqiptoj një sanksion penal me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit, ndërsa me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, si rrethanë lehtësuese të merret parasysh pranimi i fajësisë, ndërsa si rrethanë rënduese shkalla e përgjegjësisë penale, intesiteti i rrezikimit po dëmtimit të vlerës së mbrojtur.

Mbrojtësi i të pandehurit M.V, av.Bedri Miftari pasi që i pandehuri pranoi fajësinë, theksoi se pranimi është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion, duke i paraparë të gjitha favoret dhe pasojat e pranimin të fajësisë. Me rastin e dënimi nga gjykata kërkoi të merret parasysh fakti se i pandehuri menjëherë pas kryerjes së veprës penale është lajmëruar në polici, asnjëherë më parë nuk ka qenë i dënuar dhe nga koha e kryerjes së veprës penale ka kaluar një kohë e gjatë.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i akuzuari, e në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, në këtë drejtim ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për miratimin e fajësisë për të akuzuarin.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2015/SE/197 i datës 12.12.2015; deklarata e të dëmtuarit M.M i datës 14.12.2015 dhe 15.12.2015; deklarata e të pandehurit e datës 14.12.2015; foto albumi nga vendi i ngjarjes (gjithsej 12 fotografi); raporti policor i datës 12.12.2015; shënimi zyrtar i datës 13.12.2015; si dhe shkresat tjera të lëndës.

Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë të këtyre provave dhe pranimi të fajësisë, konsiderojmë se përtej çdo dyshimi është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, duke i'u tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimi të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lartë, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari M.V ka kryer veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1, nën-par. 1.1 të KPRK-së, e për të cilën veprë është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në shtatë (7) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së. Gjykata, si rrethana rënduese gjykata vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale, dashjen e tij, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë, kontributin esencial të tij në këtë veprë penale, ndërsa rrethana tjera rënduese nuk ka gjetur. Ndërsa si rrethanë veçanërisht lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale nga i akuzuari, i njëjti ka treguar sjellje të mirë në gjykatë, pendimin e shprehur për rastin e ndodhur dhe premtimin e dhënë para gjykatës së më nuk do të përsërisë veprime të tilla, faktin se i pandehuri menjëherë pas kryerjes së veprës

penale personalisht është lajmëruar në polici, ka kthyer parat e marra palës së dëmtuar, që nga koha e kryerjes së kësaj vepre penale nuk ka qenë i dënuar, mosha e re e tij në kohën e kryerjes së veprës penale, si dhe faktin se nga kryerja e veprës penale kanë kaluar pothuajse nëntë (9) vite.

Gjykata, në kuptim të nenit 75 të KPRK-së ka aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit, duke u bazuar në faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë dhe se pranimi i fajësisë është rrethanë ligjore, në kuptim të nenin 75 par.1, nën-par.1.3 të KPRK-së, që gjykata të shqiptojë dënim nën minimumin e dënimit të paraparë për këtë vepër. Megjithatë, me rastin e zbutjes së dënimit, janë respektuar kufijtë e zbutjes sipas nenit 76 par.1, nën-par. 1.3 të KPRK-së, që në rastet e tilla, kur minimumi i dënimit për veprën penale është tre (3) vjet, dënimi mund të zbutet deri në një (1) vit.

Sa i përket dënimit me gjobë në këtë rast për të pandehurit gjykata përveç rrethanave të cekura, ka vlerësuar dhe ka marrë parasysh edhe kushtet dhe mundësitë materiale për pagimin e gjobës, duke vlerësuar se dënimi me gjobë i shqiptuar për të pandehurin është i përballueshëm për kushtet ekonomike të tij.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me burgim të kushtëzuar dhe dënimit me gjobë të cilin i pandehuri është i obliguar ta paguaj pas plotëfuqishmërisë, ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurin. Po ashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 par.1 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata, të pandehurit kohën e kaluar në masën e arrestit shtëpiak, nga data 14.12.2015 e deri me datë 11.01.2016, ia ka llogaritur në dënim e shqiptuar me burgim të kushtëzuar. Kjo duke u bazuar në nenin 83 të KPRK-së, ku përcaktohet se koha e kaluar në masë llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 lidhur me par.1 dhe nenit 452 par. 1 të KPPK-së. Ndërsa

taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 par. 3 nën. par 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Për kërkesën pasurore juridike, gjykata ka vendosur në mbështetje të nenit 462 të KPP-së, ashtu që palën e dëmtuar e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko – civil.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 358, 364, 449, 462 të KPPK-ës, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Dega në Leposaviq**

**Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal**

**P.nr.31/2017, datë 28.05.2024**

**Bashkëpunëtore profesionale**

**Edita Koliqi**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese**

**Qëndresa Tahiri - Islami**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.